



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit  
Opština Lipjan – Municipality of Lipjan  
DREJTORIA E ARSIMIT

oh Nr. 600/01-60/00  
Data: 23.10.2023

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 08L-153 mbi Edukimin në fëmijërinë e hershme, neni 4 paragrafi 8 i Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpall këtë:

## KONKURS

**Për regjistrimin e fëmijëve në Institucion Parashkollor publik në QEAP “Çerdhja”-Lipjan paralelja e ndara fizike në Shalë për vitin 2023/2024 për grup moshat nga 1-5 vjeç.**

### I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Vërtetim vendbanimi nga Bashkësia Lokale;
- Faturën e shërbimeve komunale, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë;
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Dëshminë që ka fëmijë të tjerë të regjistruar në institucionin parashkollor përkatës.

### II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucion parashkollor:

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligji nr. 08L-153 mbi Edukimin në fëmijërinë e hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë.

### III. Afati dhe mënyra e aplikimit:

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më: **23.10.2023 deri më datën 31.10.2023;**
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës **çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 13:00.**
- Shpallja e rezultateve bëhet **më datë: 03.11.2023** në institucionin parashkollor përkatës;
- **Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

Në: Lipjan  
Më datë: 23.10.2023

